



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE



Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3 pika (ç) të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh nenin 23 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, si dhe nenin 2 të Aneksit të kësaj Kontrate,

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës numër 02/201 të datës 31.05.2006,

Më qëllim të thjeshtësimit të procedurave për realizimin e të drejtave nga Pushimi i lehonisë,

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2007
PËR
RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PAGESAVE
FINANCIARE PËR PUSHIM TË LEHONISË NË SHËRBIMIN CIVIL TË
KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të rregulloj dhe të përcaktoj procedurat për realizimin e pagesave financiare, gjatë tremujorit të dytë të pushimit të lehonisë për nëpunëset civile në të gjitha organet e punësimit të Shërbimit Civil të Kosovës,

Neni 2

Përfitimet nga pushimi i Lehonisë

- (1) Nëpunëset Civile të punësuar në organet e punësimit të Shërbimit Civil të Kosovës, kanë të drejt në pushim të lehonisë më pagesë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj,

- (2) Për tre (3) muajt e parë, kompensimin e pagesës së pushimit të lehonisë do ta bëjë punëdhënësi, ndërsa për tre (3) muajt e tjerë të mbetur pagesa financiare do të kompensohet nga Fondi i veçantë i krijuar nga Qeveria e Kosovës,
- (3) Varësisht nga krijimi i mundësive buxhetoret të drejtat e tjera gjatë pushimit të lehonisë, të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës do t'i realizojnë në përputhje me dispozitat e nenit 23 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe aktet ligjore e nënligjore të cilat janë të aplikueshme.
- (4) Pagesat financiare të pushimit të lehonisë prej (6) muajve të përcaktuara në nenin 23, të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës mund ta realizojnë vetëm gjatë shfrytëzimit të pushimit të lehonisë.

Neni 3

Lartësia e kompensimit të pagesës për pushim të lehonisë

- (1) Të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës, për tre (3) muajt e parë të pushimit të lehonisë kompensohen sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në Shërbimin Civil të Kosovës,
- (2) Për tre (3) mujorin e dytë të mbetur të pushimit të lehonisë do të marrin 70% të pagës minimale në Kosovë, të përcaktuar nga Këshilli Konsultativ Trepalësh (KKT) i partnerëve social,

Neni 4

Procedurat Administrative për realizimin e pagesës

- (1) Për realizimin e pagesave financiare nga pushimi i lehonisë, nëpunëset civile duhet të plotësojnë kërkesën me shkrim të përgatitur nga shërbimi i veçantë i MPMS-së,
- (2) Deri në krijimin e një organi të veçantë, kërkesat duhet dorëzuar në Zyrat rajonale apo komunale të punësimit të cilat janë pjesë integrale e DPP të MPMS-së, selitë e të cilave janë në të gjitha komunitet e Kosovës,
- (3) Shqyrtimin dhe vlerësimin përfundimtar të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës për realizimin e pagesës nga pushimi i lehonisë deri në krijimin e një shërbimi të veçantë do ta bëjë Divizioni i Ligjit të Punës dhe Marrëdhënieve në Punë i DPP të MPMS-së,
- (4) Vendimin për njohjen e të drejtës në pagesë nga pushimi i lehonisë, e nxjerr personi i autorizuar nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës,

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesën e pushimit të lehonisë

- (1) Krahas kërkesës me shkrim, për përfitimin e pagesë financiare nga pushimi i lehonisë, nëpunëset civile të Shërbimit Civil të Kosovës duhet t'i dorëzojnë edhe këto dokumente :
- Kontratën e punës të nënshkruar nga punëtorja dhe autoritetit i Organit të Punësimit ,
 - Fletëlëshimin e institucionit shëndetësor ku ka lindur fëmija,
 - Raportin për gjendjen shëndetësore të fëmijës,
 - Numrin e xhirollogarisë personale të ndonjëres nga bankat e Kosovës
 - Fotokopjen e letërnjoftimit, dhe
 - Vendimin për lejimin e pushimit të lehonisë nga punëdhënësi
- (2) Raporti për gjendjen shëndetësore të fëmijës , i cili konfirmon se fëmija është i gjallë duhet të sillet çdo 30 dite, edhe pas dorëzimit te parë me dokumentet e tjera të nevojshme ,
- (3) Nëse nëpunësja civile nuk sjell raportin mjekësor çdo 30 ditë, raport ky i cili vërteton se fëmija është i gjallë, asaj do t'i ndërpritet e drejta në pagesë për pushim te lehonisë,

Neni 6

Aktet e tjera valide për pushimin e lehonisë

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ për realizimin e drejt dhe efikas të pagesës së pushimit të lehonisë është edhe vendimi për pagesën e pushimit të lehonisë dhe kërkesa për pagesën e pushimit të lehonisë e plotësuar nga vetë punëtorja .

Neni 7

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së,

Prishtinë , shkurt 2007	Ministri i MPMS-së <hr/> Ibrahim Selmanaj
--------------------------------	--